



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Psikolinguistikë

Ngarkesa: 5 Kredite - (leks. 40, sem. 10)

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në “Mësuesi të Gjuhës italiane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nene 4, 6,7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të kuptojnë se si njohuritë gjuhësore organizohen dhe përpunohen nga mendja e njeriut. Të zhvillojnë njohuri të mira mbi disiplinat e tjera që përfshijnë psikolinguistikën si: bazat biologjike të gjuhës (gjuha dhe truri), perceptimi i të folurës, leksiku, përvetësimi i fjalisë, ligjërimi, prodhimi dhe përfitim i gjuhës. Të kuptojnë të dhënat nga perceptimi dhe prodhimi i gjuhës dhe se si këto të dhëna kanë ndihmuar në zhvillimin e teorive kryesore të psikolinguistikës. Të fitohet një kuptim më i thellë i proceseve psikologjike që ndihmojnë në përfitim të gjuhës së huaj.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohin dhe analizojnë çështjet kryesore lidhur me perceptimin e të folurit, njohjen leksikore, ndarjen e fjalive dhe të tekstit në pjesë si dhe përvetësimin e gjuhës dhe aftësive të leximit.
2. Të përshkruajnë dhe shpjegojnë çështjet më të rëndësishme të lidhjes së trurit me gjuhën dhe se si gjuha përftohet, përpunohet dhe ruhet.
3. Të kuptojnë lidhjen midis gjuhësisë së zbatuar, përfimit të gjuhës së huaj dhe psikolinguistikës.
4. Të fitojnë aftësinë për të studiuar gjuhësinë e zbatuar dhe gjuhën e huaj nga një këndvështrim psikolinguistik.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti demonstroi njohuri të qëndrueshme mbi proceset psikologjike që qëndrojnë në themel të përvetësimit, prodhimit dhe kuptimit të gjuhës, si dhe lidhjet midis gjuhës, mendimit dhe kujtesës.
2. Studenti është në gjendje të analizojë dhe të vlerësojë mekanizmat e përbashkëta të funksionimit të gjuhëve të ndryshme, duke shmangur fokusin në veçoritë strukturore të gjuhëve dhe duke theksuar natyrën universale të aftësisë gjuhësore.
3. Studenti kupton dhe shpjegon çështje kyçe si bilingualizmi, përvetësimi i gjuhës së huaj, leximi, shkrimi dhe trajtimi i sfidave në mësimin e gjuhës, duke i aplikuar këto njohuri në kontekste arsimore dhe kërkimore.